

# NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

*Prirje të gjuhës shqipe në Kosovë,  
pas qershorit 1999*

## Zhvillimet bashkëkohore të gjuhës standarte

Studim nga Prof. Dr. Rexhep Ismajlli

faqe 8



*Zbulohen dokumente të shkruara 90 vjet  
më parë*

## Të pathënat e Kongresit të Lushnjes

Dossier ga Izet Shehu

faqe 22



## EDITORIAL

### *Patriot Part time*

Nga Qazim D. Shehu

Sot, të tymosesh patriotizëm është gjëja më e lehtë. Dhjetra gazeta, shoqata, qindra libra për krahinat flirtojnë patriotizëm. Në kohën e globalizmit fleksibël nevoja për patriotizëm është e madhe. Njoh një profesor në histori, arkeologji, i cili dje ka qenë dikush dhe ngaqë s'është në pozitë e djeshme, gomën e shpëtimit e ka gjetur tek patriotizmi. Nëse je ulur me të në tavolinë dhe merakun e ke se fëmijes sate nuk ia bleve dot këpucët të reja, ai të flet për patriotizmin, nëse ty të dhemb koka, ai prapë të flet për patriotizmin, dhe të jep aspirinën e tij si ilaçin më shpëtimtar, dhe nëse ty prapë

Vijon në faqen 3

### *Arti muzikor, rob i kopjimeve*

Nga Astrit Veliqi

Siç e dimë, muzika ose më mirë të themi arti muzikor, përfaqëson një sferë mjaft të rëndësishme në prezantimin e vlerave kulturore tek ne.

Këto vlera artistike artikulojnë një frymë autentike shumë të pasur nacionale, por, mëgjithatë, marrë në përgjithësi, në shumë raste edhe konstruktohen fiktive, jo burimore e të vjedhura.

Por ajo që në shikim të parë duket interesante në këtë mish-mash kulturor, është prezantimi i kësaj sfere në mediat e shkruara e, në veçanti, ato elektronike, ku në këto të fundit shfaqen me rrymat dhe zhanret më moderne të artit muzikor si rok, aren-bi, rep, popullore, të lehta, blues-jazz etj.

Vijon në faqen 16

*Lesing, centralistja që ftoi çmimin nobël në letërsi*

# “Ditari i artë” i Doris Lesing

faqe 13



## Në BRENDËSI

### Shalli i mëndafshtë

Tregim nga Herta Myller

faqe 7

### Shpirt tridimensional

Kritikë nga Gjekë Marinaj

faqe 6

### “Varka e zbrazët”

Poezi nga Uejn Miler

### “Alfabet vezullimi”

Poezi nga Nikol Gdalia

faqe 5-12

### Proza e Jaho Markgjakajt

Kritikë nga Prof. Dr. Murat Gecaj

faqe 11

### “Ajo që dua..”

Kritikë nga Mexhit Prençi

faqe 15

### Letërsia e pasviteve '90

Opinion nga Vilhelme Haxhiraj

faqe 3

### Tregime nga: Namik Mane, Mark Simoni, Istref Haxhillari

faqe 17-21

### Poezi nga: Adelina Mamaqi, Ali M. Lajçi, Ibrahim Vasjari Syehlj Havolli

faqe 9-19

### Esse nga: Qazim Shemaj, Qamil Gjyrezi, Mirela Xara, Astrit Veliqi, Skënder Mulliqi, Spase Thanasi, Isuf Meshi

faqe 10-18



Albanian Refining & Marketing of Oil

**PËR HERË TË PARË  
EURODIESEL  
I STANDARTEVE EUROPIANE**

**PCALBANIA**  
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art

Rreth poezisë së Maksim Zotaj

## NJË SHPIRT TRI-DIMENCIONAL



Edhe për poetin Maksim Zotaj, ashtu si për të gjithë artistët, arti është një mirazh gjithnjë në lëvizje. Ai shfaqet para shpirtit të etur për atë substancën maksimale që i jep shijen përfundimtare të bukurës, para thonjëve në ngulule e sipër drejt terreneve të pabindura njerëzore dhe para mendjeve që mprehen nga tehu i dallgëve të oqeanit të ndjenjës. Por, për fat të mirë, arti gjithmonë e ruan atë largësinë e nevojshme me artistin.

Nga Gjekë Marinaj

Koha ka vërtetuar se çdo artist e transmeton këtë distancë në momente të veçanta—nëpërmjet sinjalesh të ndryshme, nëpërmjet metaforash. Zotaj e ka ruajtur poetizimin e kësaj largësie brenda vetes gjatë gjithë jetës së tij, për të pagëzuar me të librin e tij të parë *Largësi e Trishtueshme*. Nesë i besojmë Longfelloë-s, kur thotë se “Arti është i gjatë dhe koha është në fluturim” (Davidoff 9), vargjet që pasojnë e pasqyrojnë këtë kombinim kohë-distancë-shpirt më së miri:

*Shpirti im për ku po rend kështu vallë?  
Ndryshon ai, si moshë e një vajze,  
Që nuk mbelet gjithmonë vajzë  
Ndjenjës sime çdo çast i lëkundet si figurë,  
E cila duke i dhënë dorën një tjerë,  
Kalon edhe ajo (Zotaj 39).*

Gjuha figurative e përdorur në këto vargje na nxit të mendojmë se kjo largësi është e trishtueshme për poetin në më shumë se një aspekt dhe më tepër se në një formë.

Këtë shqetësim e gjejmë të gdhendur haptazi kudo në lulesat e gjurmëve të shpirtit të tij tri-dimencional. Them tri-dimencional sepse, në këtë libër, shpirti i Zotajt është i dhënë njëherësh pas delikatesës që lypë poezia, pas përkushtimit dhe etikës që kërkon arti i përkthimit dhe pas sekretit profesionalo-artistik që duhet aplikuar ndaj dritëhijëve dhe këndvështrimit artistik në fotografi. Dhe të tri fronteve ua del mbanë me autoritet profesional dhe me karakter njerezor që të frymëzojnë.

Poezia zë kryet e vendit në sofrën e shtruar poetike të Zotajt. Poeti është ulur këmbëkryq me motivet a tij që nga viti 1977 e deri më sot. Megjithatë, ndryshe nga shumia e poetëve tanë, bshkëkohorë, ai është më i shqetësuar me të tanishmën dhe të ardhmen se sa me të kaluarën në poezinë e tij. Zotaj e përmbledhë gjithë filozofinë e tij për lidhjet me të kaluarën me këta tre rreshta:

*Ti padyshim më do mua,  
Edhe unë ty!  
A mund ta lëmë me kaq (Zotaj 53)?*

Kjo poezi mund të përdoren si mostër e poezisë së Zotajt dhe ideja e saj si njëra prej cilësive të poezisë së tij. Është e rëndësishme të kuptohet se dy vargjet e para të poezisë mund të deshi-frohen në dy mënyra: si bisedë me dashurinë absolute të poetit me të kaluarën (pavarësisht nëse poeti flet me një njeri, me një regjim apo me një nishan kohor) ose si antonim i plotë i kësaj dashurie. Kurse vargu i tretë, ai ka një dhe vetëm një kuptim—atë që lexojmë, fjalë për fjalë: “A mund ta lëmë me kaq?”

Aq më tepër, pasi përfundon së lexuari librin *Largësi e Trishtueshme* e ndjenë se ke të bësh me një buqetë të përbërë prej 54 lulesh shumëngjyreshe të freskëta. Ç’është më e mira, kjo buqetë e bukur poetike është funksionale. Ajo vërtet qëndron mendshëm tek koka e vdekur e së kaluarës, por aroma dhe komunikimi i brendshëm filozofik që jep e fton lexuesin t’i kushtojë vëmendje më të madhe pikës që duan

të mbrijnë në jetë se sa pikës në të cilën e filluan atë.

Poezia e Maksim Zotajt ka edhe cilësi të tjera. Ajo është një poezi e prekshme, por në të njëjtën kohë e tejdukshme. Parimisht, është një poezi e pangarkuar me vrerë ndaj njeriut të lig apo fateve të këqia të së tanishmes. Sygjerimet poetike rrjellin me pastërtinë e një burimi në mal—ku lexuesi mund t’i përdorin ato krejtësisht sipas dëshirës së tij, pa asnjë shtytje letrare. Në librin *Largësi e Trishtueshme* nuk ka “rrahje grushtash” mbi fletën e bardhë. Aty gjithçka ka sikuencën e vet natyrale. Gjithsesi,



mundimi për ta rrokë të bukurën është evident në poezinë e Zotajt. Sa për t’i provuar efektet, le të lejojmë mbi fytyrë ca pikëla nga vesa i tij poetike:

*Nata thërmohet mbi nota këngësh,  
Duke u larguar ngadalë dhe ndihet e vetmuar!  
Rrëshqet ajo mbi linjat e padukshme,  
Si mbi gjurmë motevesh të lodhura (Zotaj 56).*

Siç e thamë më lart, në këtë aspekt, kemi të bëjmë përsëri me atë largësinë artist-mirazh. Kymirazh, ndnose e ka një lidhje elastike të padukshme me artistët, ai prapë se prapë mbetet vetëm mirazhë para tij. Ndryshe ai nuk mund të quhej art. Ai është mirazh sepse nuk ekziston fillimisht, por krijohet nga artisti, bazuar në ato ngjyra, në atë qiell mendimesh, në atë vorbull dhimbjesh dhe në atë gjithësi imagjinitive që natyra ua beson vetëm njerëzve të artit.

Afërsisht tek në të njëjtën orbitë silllet edhe esenca e raportit poet-përkthyes. Në pjesën e dytë të librit *Largësi e Trishtueshme* gjejmë disa nga zërat më të respektuar të letërsisë amerikane të shekulli XX-të. Megjithëse jam i ndërgjegjshëm se poezia e përkthyer në një gjuhë tjetër nuk mund të jetë kurrë e të njëjtit nivel me origjinalen, unë edhe mund të thoj se Maksim Zotaj e ka arritur artin e vërtet në përk-

thimin e poezive të poetëve që ka zgjedhur. Por, mendoj se vet Maksimi, thellë në shpirt do të mendonte se një vlerësim i tillë do të ishte më efikas po të thoja se përkthimi i tij u është afruar aq sa ç’është e mundur poezive origjinale. Kjo edhe për një arsye tjetër: projektori më real që ndriçon ngjitjen e një përkthyesi në shkallët e pafundme të artit të përkthimit është një barometër e ftoft, ireal, është një termometër subjektiv—treguesi i së cilit ulet dhe ngjitet nga stimulimi i frymës së fjalëve të kritikëve dhe dashamirësve të letërsisë si unë, por nuk është i bazuar një kontroll perçiz të kualitetit që gjendet aty. Sa për

të shuar kureshtjen e lexuesit, ja poezia Fog/ Mjegull e Sandburg-ut në origjinal shoqëruar nga e njëjta poezi e shqipëruar nga Zotaj:

*The fog comes  
on little cat feet.*

*It sits looking  
over harbor and city  
on silent haunches  
and then moves on  
(Sandburg).*

\*\*\*

*Mjegulla vjen  
Si mbi gjurmë të lehta maceje.*

*Ajo ulet, duke vështuar  
Mbi limanet dhe qy-*

*tetin,  
Ne heshtje e përgjumur,  
E pastaj shkon (Zotaj 80)!*

Arti është magjik dhe domethënia e kësaj magjie gjendet e shkruar jo në pikën më të skajshme që prek përkthyesi në punën e tij, por në lulesat që lenë gjurmët e tij për të arritë këtë pikë. Përkthimet e Zotajt, i japim mundësinë lexuesit shqiptar për një njohje më të afërt me poezinë e poetëve amerikanë. Në të njëjtën kohë, duke thelluar njohuritë tona ndaj punës së këtyre poetëve, njohim më mirë se kush është Maksim Zotaj, cila është tematika e përkthimeve të tij, si dhe cilat janë interesat e tij ndaj poezisë së huaj. Tek mësojmë se pjasa e dytë e librit në shumë drejtime është një zgjatje e natyrshme e linjës poetike të poezisë së Zotajt, bindemi se përkthimi mbetet një rikrijim i përkthyesit aq sa ç’është krijimtari e poetit të përkthyer.

Për të ripërkufizuar vlerat e punës së Zotajt si përkthyes le ta lëmë me kaq: poezitë e poetëve amerikanë luajnë rolin e një ure të bukur letrare që lidhë poezinë e Zotajt, në pjesën e parë të librit, me pjesën e tretë—“poezinë fotografike” (Zotaj 5), siç i quan autori. Lidhja bëhet në mënyrë natyrale, duke e ruajtur spontanitetin artistik dhe boshtin e ideve...

Faktikisht Zotaj ka të drejtë kur e quan punën e

tij me aparatit fotografik poezi. Sepse poezia, si domos poezia lirike, vërtet është një fotografi e çastit. Artisti frymëzohet apo ngacmohet nga diçka e veçantë dhe instinktivisht ai imazh regjistrohët në mendje, në film, në letër ose në të tria njëherësh. Ja se si e vlerëson punën fotografike të Zotajt Paul Aresu:

Tek i vështroj fotografitë e Zotajt, s’mbahem dot pa u ndalur te bukurina, kualiteti spontan i kapjes së tij piktoreske, e cila mund të vinte vetëm nga një njeri që s’është i lindur në kulturën Amerikane. Është një vizion i dliirë, emocional dhe shumë personal. Llojshmëria e temave të zgjellura nga Maksi është madhrisht e veçantë dhe shumë vetanalitike. Ai e fotografon botën e tij me çiltërsi dhe dliirësi të plotë. Aty nuk ka bagazh. Ai sheh nga zemra e tij. Trainimi formal për artin as që futet në ekuacion, siç ndollë sot me shumicën e fotografëve dhe fotografive. Aty gjendet një ndjenje befasie e përzier me qetësinë e çdo fotografie. Ai na jep neve Nju Jorkun nëpërmes syve të një njeriu që e njeh bukurinë, për shkak se ai u lind në një vend të bukur, në Shqipëri. Në fotografitë e Maksit ka befasia po jo mister. Aty nuk ka as motive të mëtejshme as rend dite. Ai na tregon neve atë që sheh. Arsyja që ne i buzëqeshim punës së tij është se aty kemi të bëjmë me një vizion të së sinqert, me një vizion të vërtet. Ne e çmojmë punën e Maksit sepse nuk ka shumë fotografë që janë kaq të disponueshëm dhe të tejdukshëm në punën e tyre (Zotaj 129). (Përkthimi nga anglishtja bërë nga autori i këtij shkrimi).

Për të bërë Paul Aresu-të e botës të arrijnë në një konkluzion të tillë vlerësimi ndaj punës së tij fotografike, Zotaj i është dashur të aplikojnë më shumë se sinqeritet personal, këndvështrim artistike apo kapje momentesh dramatike në punën e tij.

Në një nga punimet e tij titulluar “The Eaters Mirror” (Zotaj 137), bota e brendëshme e autorit nuk është e rëndësishme së parë. Në këto tip fotografishë gjëja me e rëndësishme është aspekti teknik i punës. Në këtë foto Zotaj tregon se ai ka kontroll të plotë mbi aparatit fotografik kundrejt mundësisë që aparati të ketë kontroll të plotë mbi të. Për fotografinë në fjalë, nevoja e atyshme për një thellësi me precizion të hapësirës është imperative. Pra kemi të bëjmë me distancën nga afër deri larg të fotografisë, me qëllim që të gjitha objektet të kenë atë mprehtësinë dhe kontrastin që, falë Zotajt, kanë.

Pothuajse të gjitha fotografitë e futura në *Largësi e Trishtueshme* kanë të veçavtat e tyre edhe në aspektin teknik. Përdorimi me profesionalizëm i dritës, kontrastit dhe tonalitetit, strukturës, prerjes kormizore, përvijimit dhe i ekujlibrit janë gërshetuar mjeshtrisht me efektet e brendëshme poetiko-metaforike të autorit.

Me *Largësi e Trishtueshme* Maksim Zotaj na afron më shumë se një potikë të bukur, ai na afron ADN-në e tij. Dëshira e tij për t’u identifikuar me lexuesin, aq sa ç’është dëshira që lexuesi të identifikohet me punën e tij, është admiruese. Fletët e këtij librit janë dyer të hapura për tek zemra e Zotajt jo vetëm si poet, përkthyes apo fotograf, por edhe si njeri.